

NOTE INFORMUESE

Mbi kërkesën për procedim disiplinor me masën “Vërejtje publike”, për prokuroren E.K.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nisur hetimin disiplinor me iniciativë dhe ankesë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe 18 organizata të shoqërisë civile ndaj magjistrates E.K., me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuara në nenin 102/1 shkronja dh, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Shkak për fillimin e këtij hetimi disiplinor janë bërë faktet e bëra publike në datë 21.02.2020, në media mbi vetvrasjen në mjediset e Burgut nr.313 të shtetasit Bilbil Hasani, babai i 4 fëmijëve. Në media është bërë prezent fakti se ky shtetas ndodhej prej disa muajsh me masën e sigurimit “arrest në burg” për veprën penale të “vjedhjes” së një sasive prej 1200 lekë, kishte probleme të shëndetit mendor dhe ishte në pritje të caktimit të seancës paraprake.

Hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë konkludon se:

- Magjistratja E.K. ka kryer shkelje disiplinore për shkak të mosveprimit profesional: pasi u vu në dijeni, gjatë seancës së masës së sigurimit, për të dhënat mbi gjendjen e rëndë mendore të Bilbil Hasanit, ajo nuk i përdori ato si indicie për të ndërmarrë veprime të mtejshme hetimore, veçanërisht kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjor dhe verifikimin e përgjegjshmërisë së tij penale. Sipas raportit, ky pasivitet përbën moszbatim të detyrimeve të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe plotëson elementet e shkeljes disiplinore.
- Shkelja vlerësohet se është kryer nga pakujdesia, në formën e neglizhencës, jo me dashje. Në vlerësim është marrë parasysh edhe ngarkesa shumë e lartë në punë. Megjithatë, për shkak të përvojës 27 vjeçare dhe rolit të saj si prokurore e vlerësuar profesionalisht me rezultate shumë të mira dhe ushtrimit të funksionit të drejtueses së prokurorisë për disa vite, ajo kishte mundësi të parashikonte pasojat e mosveprimit.
- Mosveprimi i prokurores pengoi verifikimin e gjendjes mendore të të pandehurit dhe marrjen e masave të përshtatshme. Çështja vijoi drejt gjykimit dhe Hasani qëndroi në institucionin e vuajtjes së dënimit. Megjithatë, raporti i ILD-së thekson se mosveprimi i prokurores nuk rezulton të ketë shkaktuar vdekjen e tij.
- Shkelja konsiderohet se ka cenuar imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut, pasi çështja mori vëmendje të konsiderueshme në median e shkruar dhe vizive.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson në raport se duke marrë në konsideratë mes tw tjerash se shkelja është kryer nga neglizhenca, për herë të parë, ngarkesën e lartë të punës, e vlerëson shkeljen si të lehtë dhe i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike”, e parashikuara nga neni 105 paragrafi 1 shkronja a dhe neni 107 i ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin”, për shkeljen disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronjat “dh”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

